

MILAN JAZBECI, THIS INNOVATOR IN POETRY

MILAN JAZBECI, KY INOVATOR NË POEZI

Luljeta ADILI-ÇELIKU¹, Meral VESELI²

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology „Bllazhe Koneski”, University „Ss. Cyril and Methodius” in Skopje

² Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Languages, Cultures and Communication, SEEU

*Corresponding author e-mail: l.adili@flf.ukim.edu.mk & m.shehabi@seeu.edu.mk

Abstract

In this study we have tried to present to the Albanian reader a concise overview of the poems of the Slovenian poet, Milan Jazbec. Perhaps the poet in question is known only as a diplomat for the fact that he was also the ambassador of his country in Northern Macedonia, but we also find him as a writer of novels and poems, whose works have been translated into Albanian. When we stopped and analyzed the poet's poems we saw that his poetry is very special both in form and content. We saw a verse, which is composed of only one word, a verse-lexeme, which has the power of an ordinary verse. This is something unprecedented so far in the waters of poetry and with this the poet brings an innovation, a model which can become a good example.

As for the content of the poems, we have lyrical poems with a love theme. Love for the homeland, the girl and life. What characterizes these poems and which emerges as a common denominator is the dialogue that the poet develops. A dialogue, which takes place between him and what he lives and experiences. We have a dialogue between the narrator and his daughter, in which only the narrator speaks dialogue, but what is said implies that there is an answer, hence we call it dialogue. Conversation is found in all the poems of the poet; it happens even when he does not get an answer from the interlocutor. In the end we have seen the language of the poet in linguistic terms separating it from the literary one. This article is part of the foreword to the poet's work entitled “77 niansi nežosti” written for poems selected from the poet's trilogy.

Keywords: *diploma, poet, poetry, conversation, lexeme, innovator.*

Përmbledhje

Në këtë studim përpara lexuesit shqiptar paraqesim një pasqyrë të poezive të poetit sloven, Milan Jazbec. Ndoshta poeti në fjalë njihet vetëm si diplomat për faktin se ka qenë edhe ambasador i vendit të tij në Maqedoninë e Veriut, por atë e gjejmë edhe si një shkrimtar romanesh dhe poezishë, veprat e të cilit i kemi të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Ne që u ndalëm dhe analizuam poezitë e poetit pamë se poezia e tij është shumë e veçantë si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja. Pamë një varg, i cili është i përbërë vetëm nga një fjalë e vetme, një varg-lexemë, i cili ka fuqinë e një vargu të zakonshëm. Kjo është diçka e paparë deri më tani në ujrën e poezisë dhe me këtë poeti sjell një risi, një model i cili mund të bëhet shembull i mirë për t'u ndjekur.

Sa i takon përmbajtjes së poezive, kemi poezi lirike me temë dashurie. Dashuri ndaj atdheut, vashës dhe jetës. Ajo që i karakterizon këto poezi dhe që na del si një emërues i përbashkët është dialogu që zhvillon poeti. Një dialog, i cili ndodh në mes tij dhe asaj që ai e jeton dhe e përjeton. Kemi dialog në mes të narratorit dhe vashës së tij, në të cilin dialog flet vetëm narratori, por ajo që flitet lë të nënkuptohet se ka një përgjigje, prandaj ne e quajmë dialog. Bashkëbisedimin e gjejmë te të gjitha poezitë e poetit, ai ndodh edhe kur nuk merr një përgjigje na ana e bashkëbiseduesit. Në fund kemi parë gjuhën e poetit në aspektin gjuhësor duke e ndarë nga ai letrar. Ky shkrimi është pjesë e parathënies së veprës së poetit me titull “77 niansi nežosti” shkruar për poezitë e përzgjedhura nga trilogjia e poetit.

Fjalët kyçe: *diplomat, poet, poezi, bashkëbisedim, lexemë, novator.*

Hyrje

Ambasadori Milan Jazbec, ky shkrimtar i kohëve tona, ka dekada që shkruan mbi diplomacinë dhe për diplomacinë. Kemi romanet e tij shumë të bukura që janë një gërshetim mbi diplomacinë dhe jetën private të një diplomati, të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Vitet e fundit ka nxjerrë në pah edhe anën tjetër të tij, atë të poetit duke u hapur punë kështu të gjithë kritikëve letrarë e studiuesve gjuhësorë. Poezia e tij si duket ka qenë e fshehur në thellësi të shpirtit të tij e shtypur nga diplomacia që ka ushtruar poeti, e është dashur të vijë koha dhe momenti që të dalë nga ai për të tingëlluar fuqishëm e për t'u bërë aq e dashur për lexuesi e fjalës së tij.

Ndoshta poezia dhe veprat e tij poetike janë një premtim që do të përmbushë shkrimtari, pasi poezia është ajo më delikatja, është mjalti i artit, më e brishta, ajo që kërkon ndjesi më të thellë se zakonisht, atë të një adoleshenti. Kjo ndjenjë kaq e madhe, paraqitur nëpërmjet vargjeve poetike, është një zbulim i madh në jetën e njeriut dhe mund të vijë edhe kur je në një moshë pak më të madhe, pasi ajo është më e fuqishme se jeta, është një liri, është një robëri, është një fshehtësi “*më e fshehtë sesa fshehtësia*”. Mund lirisht të themi se poeti i realizon të dyja nëpërmjet këtyre vaprave poetike, edhe premtimin e shkrimtarit për të shkruar poezi për ndjenjën e dashurisë e “cila dashuronte vetë”, siç do të shkruan Lasgushi “*Nuk dashuronim as unë as ti, por dashuronte dashuria*”.

Në këtë pikë sigurisht që mund ta krahasojmë me Lasgush Poradecin, ashtu si ai edhe Milan Jazbeci shkruan poezi për vashën e tij, e cila i vjen në jetë në një moshë pak më të madhe dhe e rremben poetin pa e kuptuar as vetë ai. Për dallim nga i pari, ky i dyti arriti ta realizojë trilogjinë me poezi për vashën e tij, kurse Lasgushi realizoi dy nga të paralajmëruara. Ajo që ngjasojnë këta dy poetë është edhe mënyra se si i trajtojnë temat, si atë të dashurisë, të filozofisë së jetës e të vdekjes. Kur e kërkoi autori që të shkruaj një shkrim për përmbledhjen me poezinë e tij me titull “*77 niansi nezosti*”, sa u gëzova aq edhe u shtanga, pasi nuk dija a do të arrija të shkruaja bukur mbi poezitë sa janë të bukura vetë ato, mos vallë do ta prishja bukurinë dhe hijeshinë atyre?

Pastaj, poezitë lirike janë shumë të vështira për t'i shtjelluar, ato nuk janë për t'u analizuar, por vetëm për t'u përjetuar, pasi shprehinë thjeshtësinë e ndjenjave që vetëm mund të ndihen dhe shijohen, janë shumë të qarta, janë shumë transparente, shihet shumë hapur “zemra” e poetit. Shpesh ndodh që të kriset kjo brishtësi nga kritika letrare duke dashur që t'i analizojë ato, pikërisht kjo ishte ajo që më bëri të shtangesha, frika nga shprishja e asaj që është gdhendur me aq mjeshtri nga vetë mjeshtri. Poezi këto kaq të bukura dhe shumë të veçanta si nga forma ashtu edhe përmbajtja.

Milan Jazbecin patëm fatin ta njohim edhe nga afër në kohën kur ishte ambasador i Sllovenisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ishte “nxënësi i gjuhës shqipe”. Mësonte me interes të madh gjuhën shqipe. Orën e parë e kemi mbajtur pikërisht në 28 nëntor në vitin 2017, duke vazhduar t'i ndjekë mësimet e shqipes shumë i rregull deri në kohën që nisi pandemia, deri në mars të vitit 2020. Në orët e shqipes shpesh më fliste dhe për atë që shkruan, por jo për edhe poezinë e tij, ata i njohëm nëpërmjet leximit të tyre.

Bashkëbisedimi karakteristikë e poezisë së Jazbecit

Leximi i poezive të autorit është një kënaqësi e veçantë pasi shumë hapur e sheh se si dashuron dhe ndjen narratori, mund lirisht të krijosh një fotografi të qartë për të dashurën e tij, për Atë. Ajo është e bukur, e dashur, e ngrohtë, magjike, energjike, motivuese, shpresëdhënëse. Ajo që shkruan ai është si pasqyrim i saj, i shpirtit të saj, i butësisë së saj, i mirësisë së saj. Karakteristikë themelore e poezive lirike të autorit është bashkëbisedimi i narratorit me të dashurën e tij, është një rrëfim me Atë dhe për Atë, por shpeshherë bashkëbiseduesi është edhe jeta, ëndrra, dëshira.

Ai i flet jetës me një optimizëm të madh, se atë që ëndërroi dikur, tash është në dorë të tij dhe e mban shumë fortë dhe sigurt. Flet me hënën të cilën tash e sheh më qartë se çdoherë, bashkëbisedon dhe ia thotë se sa e ndriçon jetën e tij edhe kur ajo është njëçerekshe edhe kur ajo është e plotë. Bashkëbisedon me një errësirë të ëmbël, një errësirë që e ndrinë atë. Bashkëbisedon me një mëngjes të ndritur... bashkëbisedon me një buzëqeshje, me një puthje, me një përqafim, me një ledhatim, me yjet etj. Një bisedë nëpërmjet poezisë është paraqitur më poshtë. Poeti ia thotë në sy, edhe pse në mungesë të saj, ia premtan se ata të dy do të jenë bashkë, pas gjithë kësaj çmendurie që është duke ndodhur, gjithçka do të jetë si më parë.

Kur kjo
të ketë kaluar
një ditë
ne të dy
do të jemi bashkë
prapë (Jazbec, f. 47)

...

Ai zhvillon një bashkëbisedim me Atë duke e krahasuar me Sheherzadën, ia thotë shumë hapur se ajo e mban në jetë, është vetë jeta e tij emocionale. Kjo është paraqitur me vargjet më poshtë:

Shehrazadja
ime
je ti
që më
mban
në
jetë
ditë
pas dite (Jazbec, Ko tole enkrat mine, f. 125)

Këtë bashkëbisedim e gjejmë në të gjithë veprat lirike të tij, duke nisur nga e para me titull “*Ylli i ndritur me kreshtë luani*”, e cila u botuar në vitin 2017. Odiseja flet me Penelopën e tij. Kuvendojnë bashkë për të kaluarën dhe për të ardhmen e tyre. Ai flet me Atë për dashurinë që kanë ruajtur vite me radhë, si është ushqyer e ruajtur me fanatizëm. Bashkëbisedimin e gjejmë edhe kur poeti ka ditë të lumtura me Atë, por edhe kur kalon ditë të zeza, si në veprën „Ditë të zeza”. Gjithçka që ka dhe që ndjen e ndan me Atë, Asaj ia beson t’ia thotë, edhe kur Ajo e lëndon duke mos iu përgjigjur ndjenjave të tij, bashkëbisedon edhe kur Ajo nuk i kthen përgjigje. Autori mban veshur një ëndërr të thurur gjatë gjithë jetës dhe nëpërmjet këtij bashkëbisedimi na tregon copëza të asaj ëndrre të madhe. Shpesh poezitë janë vetëm një dëshirë e porealizuar apo një ndjesi që nuk e ka menduar dhe paramenduar se do ta ndjejë ai. Pra, poezitë prekin dy skajet, të dëshirës së madhe dhe të realizimit përtej dëshirës!

Poezitë
e mia
janë
refleksi
i
shpirtit
tënd
mendimeve (Jazbec, Ko tole enkrat mine, f. 137)

...

Poezitë, vargjet e të cilave janë një leksemë e vetme, një strukturë e re që e sjell shkrimtari, janë si një roman i detajuar, pasi autori i zgjedh dhe i përzgjedh fjalët për ta paraqitur bukur atë që ndjen për të dashurën e tij, ndjesi kjo kaq e thellë dhe fortë, një dashuri lahtaruese. Shihen qartë takimet e tyre, plot energji dhe entuziazëm, shihet çfarë i fal Ajo poetit, se si Ajo është fjala dhe poezia e tij, Ajo është që e mban në jetë, Ajo është vetë burimi i poezisë, është vetë poezia dhe të gjitha janë nga Ajo dhe vetëm për Atë.

Ndihet se autori shkruan e rishkruan në kontinuitet poezi për Atë, shkruan ditë për ditë poezi për dashurinë e tij, pasi kjo i mban në jetë të dy, poezia dhe dashuria që kanë për njëritjetrin, është frymëmarrja e tyre, poezia janë vetë Ata. “Ajo” është objekti kryesor i poezive të tij, shpesh është e dashura, por Ajo është edhe jeta, është edhe vendlindja, është malli që ndjen poeti për të kaluarën e tij, është ajo që jeton vetë ai në të gjitha dimensionet.

“Poezitë
e mia
për ty
të gjitha
në një
të vetme
derdhen
nga
ajo
gulojnë
tek
ajo
...” (Jazbec, f. 87)

Puna dhe përgjegjësia jonë ishte dyfish më e madhe pasi na u desh që të shkruajmë një vlerësim për poezitë e përzgjedhura nga trilogjia, e shkruar në kohën e vetizolimit, me titujt: „Kapljica si, moja kapljica”, “Kur kjo të ketë kaluar një ditë”, “Iscem nitke srebrene tvoje”, të shkruash mbi më të bukurën! E ku t’i gjenim ne ato fjalë që të ngërthenin më të bukurën e të bukurës? Të shfletonim fjalët kadareane që i futën në radhën e fjalëve shqipe shkrimtari i madh Ismail Kadareja, apo të kërkonim ndihmë nga fjalët e ringjallura dialektore dhe krahinore po nga ai, por përsëri do të ishte e vështirë që të arrinim ta bënim siç duhej, pasi poezia lirike është për t’u shijuar, ajo mund të ndihet fortë dhe fuqishëm, por nuk është e lehtë të gjesh fjalë të shkruash për të e të jenë ato mbi më të bukurën e fjalëve të poetit, i cili nëpërmjet vargjeve-leksema e kalon vetveten, duke dëshmuar se këto poezi janë më të mëdha se jeta e vdekja.

Nuk do të ketë qenë e lehtë përzgjedhja e 77 poezive nga tri veprat poetike, pasi të gjithë 189 poezitë e trilogjisë janë perla në vete që bëjnë gjerdanin e çmuar për Atë, e cila e mban shumë krenare këtë gjerdan në shpirt dhe në zemër. Materiali me të cilën janë krijuar perlat është shpirti i poetit, Ajo e “ka në dorë” shpirtin e brishtë të tij, i derdhur në poezi, i ekspozuar që ajo ta shohë çdo detal të tij se si e adhuron ai, se sa e do edhe kur janë bashkë edhe kur ajo nuk është aty, se e ndjen edhe kur nuk mund ta ndjejë, e dëgjon të qeshurën e saj edhe kur nuk janë bashkë. Shpesh e krahason Atë me diellin, me hënë, me ditën, me terrin, me mëngjesin, me yjet... Si duket nuk i mjaftojnë fjalët por shkon e kërkon fuqi edhe nga trupat qiellorë për ta shprehur atë që ndjen.

Kemi poezinë *Dielli* që thotë gjithçka:

Diell
është
fytyra
jote

e buzëqeshur
 e flakëruar
 faqet
 e skuqura
 shkëndijat
 në sytë
 e tu
 fytyrë
 parajse
 ...

Gjuha në poezinë e Milan Jazbecit

Të ndalesh dhe të shohësh poezitë e Jazbecit, sigurisht që do të bëjnë përshtypje si nga forma ashtu edhe përmbajtja. Është një karakteristikë e veçantë, deri tani e paparë në ndonjë vepër, vargu i këtyre poezive. Ai është një fjalë, por shpesh është edhe një lidhës, një shkronjë e vetme. Po të numërosh fjalët e poezive do të shohësh se variojnë nga 30 leksema, ca më lart e ca më poshtë. Me një leksemë të thurësh një varg, sigurisht se duhet mjeshtri shumë e madhe, pasi të shprehësh aq fuqishëm dhe në mënyrë brilante duhet që fjala të jetë e fortë sa një varg. Por, Jazbeci ia ka dalë mbanë me këtë lloj poezie që sjell në letërsinë e sotme.

Sa i përket lëndës që përdor në poezi, është pjesë e ligjërit, në poezitë e poetit gjejmë: emra, mbiemra, përemra, numëror, folje, ndajfolje, lidhëza, pjesëza, pasthirrma, pra i kemi të gjitha pjesët e ligjeratës, ku se cila mund të përbëjnë një varg. Vargjet nuk i ndjek ndonjë rimë, por i ndjek një ritëm, lexohen me një frymë, rrjedhshëm si një lum. Poezitë sa janë të ngjashme me njëra-tjetrën aq janë të ndryshme. Të ngjashme pasi të gjitha poeti përdor një gjuhë të thjeshtë siç e bëjnë poetët kur shkruajnë poezitë lirike të zemrës, dhe të ndryshme secila trajton diçka në vete, copëza dashurie nga kalaja e hekurt që po ndërtojnë ata dy. Në këtë rast do ta citojmë Lasgushin, i cili në një rast është shprehur “*Unë besoj në dashurinë, dhe mund të them se aq sa më ka tronditur në jetë dashuria, po aq më ka gëzuar ajo*”.

Studimet gjuhësore që merremi ne si studiues i takojnë fushës së fjalëformimit, llojet e fjalëve që përdor apo që krijojnë shkrimtarët në poezitë e në veprat e tyre. Në këtë rast është pak e vështirë të bëjmë një studim të tillë, pasi poezitë origjinale janë në sllovenisht, edhe pse janë të përkthyer në shqip disa poezi të kësaj përmbledhjeje, përsëri nuk mund të japim një konkludim shkencor se çfarë lloj fjalësh nga aspekti i formimit të tyre përdor më së shumti poeti, apo mos ndonjë fjalë është krijim i tij origjinal. Një studim të tillë do ta bëjmë kur ta mësojmë gjuhën e poetit dhe do të mund të thellohem në studimet gjuhësore të fjalëve të tij. Gjithashtu, ngelen për t'u parë poezitë në gjuhën origjinale mos vallë kemi krijime që lindin nga vetë poeti dhe përkundër në poezitë e tij lirike e që pastaj të rriten e të bëhen pjesë e gjuhës standarde sllovene? Mos kemi fjalë **milaniane**? Pra, gjuha në të cilën janë shkruar poezitë mund të jetë një pikënisje për shumë studime tjera, qoftë dhe krahasimtare me gjuhën shqipe.

Referencat

- [1]. Jazbec, Milan: Ylli i ndritur me kreshë luani. Shkup:Matica, 2017
- [2]. Jazbec Milan: Црби денови. Shkup: Matica, 2019
- [3]. Jazbec, Milan: Kapljica si, moja kapljica. Shkup/ Lubjanë; Matrica dhe Forma 7, 2021
- [4]. Jazbec, Milan: Kur kjo të ketë kaluar një ditë. Shkup/ Lubjanë; Matrica dhe Forma 7, 2021
- [5]. Jazbec, Milan: Iscem nitke srebrene tvoje. Shkup/ Lubjanë; Matrica dhe Forma 7, 2021
- [6]. Poradeci, Lasgush. Ylli i zemrës. Prishtinë: Rilindja,1990.